



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Prill 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Gjatë muajit prill të vitit 2018, Drejtoria e Arsimit ka arritur me sukses dhe rezultate të larta t'i finalizojë të gjitha punët dhe detyrat të paraparë me planin e veprimit dhe punë dhe detyra tjera të paraqitura gjatë kësaj periudhe kohore.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;

- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiviteteve profesionale;
- Themelimi i Këshillit Industrial të Komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Garë e diturisë në shkencën e matematikës;
- Gara e diturisë “Fizikanët e rinj”;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Krijohet një trup komunal për bashkërendimin e përpjekjeve për përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të Kurrikulës;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e Kurrikulës së re;
- Monitorimi i zbatimit të Kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësohet gjendja e përgjithshme e infrastrukturës;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të Kurrikulës së re. Kryesisht sigurohet pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë Kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-së;

- Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore;
- P.sh. "School Me" ose platforma online të të nxënit (2018 – pilotim);
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë/kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartohet programi i investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti, e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV dhe nxënësit me talente;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;

- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me “Free balance”;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore në mënyrë sistematike me naftë;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit të arsimit fillor me kiflet dhe qumësht;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik dhe higjienik;
- Planifikimi i shpërndarjes së inventarit në shkollë;
- Fillimi i procedurave të prokurimit, “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve”;
- Fillimi i procedurave të prokurimit, “Furnizimi me ujë të shkollave”;
- Mbledhja e të dhënave për fillimin e planifikimit të investimit në kabinetet e muzikës;

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët, sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit prill të vitit 2018 kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 7 vizita informuese në shkollat fillore dhe 7 vizita të përgjithshme në institucionet arsimore në: SHFMU Asim Vokshi”, SHFMU “Rilindja”, SHFMU “Tefik Çanga”, SHFMU “Ganimete Tërbeshi”, SHFMU “Tefik Çanga”, SHML “Hoxhë K. Prishtina” dhe SHML “Sami Frashëri”;
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t’i zgjedhë 20 koordinatore të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ 24/2016;

- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara, dhe në fund të muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentoru nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa, Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimit joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues dy (2) nxënës-fëmijë, ku konstatohet se njëri fëmijë vuan nga Sindrom Down, ndërsa tjetri me dëmtime intelektuale. Kështu që, pas vlerësimit të gjendjes së tyre komisioni ka rekomanduar që të dy nxënësit të vijon mësimin në Qendrën Burimore “Përparimi”;
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;
- Gara “Fizikanët e Rinj”.

Më 19 prill 2018, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Shoqatën e Fizikanëve të Kosovës, organizuan garën e "Fizikanët e rinj" në nivel komune. Gara u zhvillua me nxënësit e klasave: IX, X, XI, XII, nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Në garën e fizikanëve të rinj, secila shkollë u përfaqësua me nxënës që kanë treguar rezultate të larta në garën në nivel shkolle. Ndërsa, nxënësit



që do të shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do të përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi, më 05 maj 2018, garë kjo që do të mbahet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (Departamentin e Fizikës), të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, nxjerrjes në pah të shkathtësive dhe kompetencave të arritura nga nxënësit në shkencën e fizikës, identifikimin e talenteve të reja dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

Drejtoria e Arsimit, në kontekst të zhvillimit, ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimensione që garantojnë progres në ngritje të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke përmirësuar infrastrukturën shkollore, pajisjen e shkollave me kabinete, laboratorë dhe mjete të ndryshme dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësor dhe të jemi në hapë me trendët dhe zhvillimet ndërkombëtare;



- GARË E DITURISË NË SHKENCËN E MATEMATIKËS

Në vazhdën e aktiviteteve dhe garave të shumta, në funksion të identifikimit të talenteve të reja, mbështetjes së tyre dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, Drejtoria e Arsimit në koordinim me studentë të Republikës së Kosovës që studiojnë në Universitetin e Koprit në Slloveni e në koordinim me këtë universitet dhe me ish-drejtoreshën e arsimit të Komunës së Gjakovës znj. Diana



Qarkaxhija, më 16 prill 2018, organizuan garën në lëndën e matematikës, në objektin e Gjimnazit Matematik. Gara u realizua me nxënësit e klasave XII, të cilët janë të interesuar për të vazhduar studimet në Degën e Matematikës në Universitetin e Primorskës, të Republikës së Sllovenisë.

Një garë me karakter të tillë, për herë të parë vitin paraprak, është realizuar në qytetin e Gjakovës, ndërsa këtë vit gara e mori një dimension më të gjerë, duke u shtrirë dhe zhvilluar në kryeqendrën e Kosovës, Prishtinë dhe në qytetin e Pejës.



Në këtë garë pjesëmarrës ishin 25 nxënës të klasave të dymbëdhjeta (XII), të cilët pasi kanë treguar shkathtësi dhe rezultate të larta në garat e zhvilluara në shkollat e tyre, iu nënshtruan testit në nivel komune.

Dy kandidatët më të suksesshëm nga garuesit pjesëmarrës të komunës sonë, do të fitojnë të drejtën për të studiuar në Republikën e Sllovenisë me burse të plotë, në vlerë për secilin nga 4.500€;

- **Trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin në praktikë të KK-së**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në funksion të zbatimit me sukses të Kurrikulës së re në institucionet edukativo-arsimore, kanë filluar trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësimeve, të cilët nga vitit shkollor 2018/19, do të fillojnë zbatimin në praktikë të këtij dokumentit zyrtar.



Është indikativ fakti se Kurrikula e re nga viti shkollor 2017, ka filluar implementimin në të gjitha shkollat e nivelit të arsimit parauniversitar, konkretisht në nivelin parafillor, fillor klasat e para (I), klasat e gjashta (VI) dhe klasat e dhjeta (X) në gjimnaze, ndërsa nga viti shkollor 2018/19, do të vazhdohet me zbatimin e KK-së edhe me klasat II, VII dhe të XI në gjimnaze.

Ky dokument përcakton një koncept të ri filozofik, i cili do të mundësojë kalimin nga Kurrikula e bazuar në përmbajtje lëndore në një Kurrikulë që promovon dhe mbështet zhvillimin e kompetencave. Kjo Kurrikulë ndihmon nxënësit, të eksplorojnë dhe kuptojnë botën rreth tyre, të ndërlikojnë përvojat e tyre të të nxënit me jetën e vërtetë dhe zhvillojnë kompetenca në nivel të lartë dhe në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.



Këto zhvillime reformuese në sferën e arsimit, kanë për qëllim edhe harmonizimin e sistemit të arsimit të Kosovës, me sistemin e arsimit të shteteve të zhvilluara evropiane.

Për t'ju përgjigje kësaj situatë në mënyrë profesionale, Drejtoria e Arsimit në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kanë hartuar politika për mbështetjen dhe



zhvillimin profesional të mësimeve për zbatimin e Kurrikulës së re nga viti i ri shkollor;

- **Vlerësimi ndërkombëtar “PISA-2018”**

Nga data 12 deri më 17 prill 2018, në Komunën e Prishtinës u zhvilluar procesi i vlerësimit ndërkombëtar “PISA-2018”, e që konsiderohet një ndër vlerësimet më reale dhe më të besueshme në botë.

Drejtoria e Arsimit, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, koordinatorët dhe mësuesit e shkollave, në funksion të një procesi të mbarë dhe të suksesshëm, iu kanë qasur me shumë seriozitet dhe profesionalizëm këtij testimit, duke realizuar me kohë të gjitha përgatitjet e duhura të parapara sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara.

Andaj, për të parë nga afër rrjedhën e procesit të testimit, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z.Jonuz Salihaj, me bashkëpunëtorë, realizuan vizita në institucionet edukativo-arsimore ku po mbahej testi, për t’i inkurajuar dhe për t’u uruar sukses nxënësve.

Në Komunën e Prishtinës këtij procesit të vlerësimit iu nënshtruan nxënësit e 23 institucioneve arsimore publike dhe private, të cilët kanë lindur gjatë vitit 2002 dhe testi u organizua në shkencë, lexim dhe matematikë.

Është indikativ fakti se vlerësimi i tillë do të jetë sa sfidues për sistemin e arsimit të Kosovës, po aq edhe i dobishëm, sepse do të nxjerrë në pah gjendjen reale të arsimit dhe do të na orientojë, tregojë se ku janë përparësitë dhe dobësitë e arsimit në Republikën e Kosovës;

- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, gjatë muajit prill organizuan manifestimin “Java me dyer të hapura”.



Ky projekt ka për qëllim orientimi në karrierë të nxënësve dhe iu dedikohet nxënësve të klasave IX. Duke organizuar vizita në institucionet e arsimit të mesëm të lartë (shkolla profesionale dhe gjimnaze) dhe disa aktivitete të ndryshme informuese për nxënësit, aktivitete të cilat ndihmojnë nxënësit në zgjedhjen e drejtimeve të tyre në arsimim e mesëm të lartë.

Andaj, nga data **23 deri më 27 prill 2018**, në Komunë e Prishtinës të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë (profesionale dhe gjimnaze), kanë realizuar projektin e dyerve të hapura dhe kanë pritur nxënësit, prindërit dhe u kanë prezantuar dhe informuar për shkollën e tyre;

- Drejtoria e Arsimit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me Kolegjin e Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”, realizuan organizimin e Edicionit të gjashtë të rivistës shkollore “Siguria në rrugë”. Ky aktivitet tashmë tradicional kontribuon në edukimin e fëmijëve për trafikun rrugor dhe përfshinë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta nga mbarë vendi.

Aktivitetet e zhvilluara tash e pesë vite në kuadër të këtij projekti, kanë dhënë fryte për sa i përket edukimit dhe vetëdijesimit të nxënësve për sigurinë në rrugë, njëkohësisht kanë ndihmuar edhe në identifikimin e njohurive të nxënësve në njohjen e rregullave dhe shenjave të trafikut, ku si rezultat i aktiviteteve në fjalë janë zhvilluar tri hulumtime:

1. Vlerësimi i njohurive të nxënësve në njohjen e rregullave dhe shenjave të trafikut, 2013;
2. Identifikimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në sigurinë e lëvizjes së nxënësve në rrugë, 2016;
3. Shkaktarët e aksidenteve nga këndvështrimi i nxënësve, 2017.

Aktiviteti u realizua më **18 maj 2018, në sheshin “Zahir Pajaziti”**, me nxënësit e klasave VI, VII dhe VIII, të cilët garuan me biçikleta, që nënkupton testimin e nxënësve për shkathtësitë teknike në ngasjen e biçikletës.

Në përfundim të këtij aktiviteti ndahen shpërblime për tri vendet e para të grupit të parë dhe tri vendet e para të grupit të dytë të nxënësve fitues;

- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, Drejtoria merr masa të menjëhershme në përputhje me legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes, e që ndërliidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Grumbullimi i të dhënave nga shkollat, lidhur me procesin e projektit, “Pilotimi me nxënësit e klasave IV, për vlerësimin ndërkombëtar “TIMSS-2019”;
- Mbledhja e të dhënave për fillimin e planifikimit të investimit në kabinetet e muzikës;

- Vizita në institucionet edukativo-arsimore, në koordinim me zyrtarët e MASHT-it, nga data 27-29 mars 2018, për të parë nga afër përgatitjen e bërë lidhur me vlerësimin ndërkombëtar “PISA 2018”;
- Vizitë qendrave testuese për mbarëvajtjen e testit “PISA 2018”, përgatitjet teknike, instalimet e softverve në kompjuterët përkatës;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit janar;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet dhe qumësht;
- Planifikimi i buxhetit vitit-18- për buxhet BDMS;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Janë nënlokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënlokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar 215 lëndë për mallra dhe shërbime si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 120 lëndë;
- Miratimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbatja e evidencës së lëndëve të zotuar me modul të blerjes dhe dorëzimi në prokurim.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Grumbullimi i të dhënave nga shkollat për Testin shtetëror të maturës;
- Krijimi i qendrave testuese për organizimin e Maturës shtetërore;
- Angazhimi i administruesve për mbarëvajtjen e testit;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;

- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese prill-2018.

4. Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 04-2018				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - obligim	Mbetje -S=
Paga	1,557,945.84	1,557,945.84	0	0
Komunali	157,613.97	42,503.75	0	115,110.22
10-MSH	705,414.36	612,687.20	92,657.09	70.07
21-MSH				
Subvencione	98,120.00	17,115.00	0	81,005.00
Donacione	72,057.73	18,771.00	0	53,286.73
FB-21-Kapitale	782,238.00	221,914.65	37,622.70	522,699.65
FB-22-Kapitale				
Gjithsej:	3,373,388.90	2,470,937.44	130,279.79	772,171.67

4.1.1. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit prill ka realizuar mbi 186 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit, janë të planifikuara gjatë katër ditë të javës.

5. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit prill të vitit 2018, janë realizuar takime me:

- zëvendësministrin e Arsimit;
- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e Zyrës franceze;
- përfaqësuesit e Zyrës japoneze;
- përfaqësuesit e organizatës EYE-zvicerane;
- përfaqësuesit e organizatës joqeveritare ETEA;
- përfaqësuesit e GIZ-it;
- përfaqësuesit e Institutit Pedagogjik IPK;
- përfaqësuesit Oportuna studentore;
- përfaqësuesit e BONEVET;
- IFC- Banka botërore;
- me Ministrinë e Financave;
- përfaqësuesit e KUR “Prishtina”;
- përfaqësuesit e ndërmarrjes “Termokos”;
- përfaqësuesit e KEDS-it;
- përfaqësuesit e PTT-së.

5.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

- Gjatë muajit prill 2018, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- Gjatë muajit prill 2018, janë pranuar gjithsej 57 lëndë, prej tyre të miratuara janë 23, të refuzuara 16 lëndë, të pezulluara 2 lëndë, të anuluar 1 lëndë dhe në proces janë 15 lëndë.

7. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësues të këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore.

8. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës, për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimin e punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re.

9. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Krijimi i ekipit profesional në nivel të DKA për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës;

- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Organizimi dhe mbajtja e "Gara e diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2018/19 dhe konsultime me MASHT;
- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2018/19;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e Kurrikulës së re;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të Kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të Kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;

- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të Kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë Kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- P.sh. “School Me” ose platforma online të të nxënit (2018 – pilotim);
- Hartohen listat për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartohet programi i investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë; nuk është mirë të duplikohet inspektimi);
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;

- DKA përkrah NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonimë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me materialet të nevojshme didaktike, higjienike dhe ushqim në mënyrë sistematike;
- Fillimi i zbatimit të projektit “ Furnizimi i shkollave me lllaptopë, projektorë dhe fotokopje”;
- Fillimi i zbatimit të projektit “ Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra”;
- Fillimi i zbatimit të projektit “ Furnizimi me rekuizita sportive i shkollave”;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

11. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.